

VENDIM
Nr.351, datë 13.5.1996

**PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË MINISTRISË SË DREJTËSISË TË DISA MJEDISEVE
TË SHTYPSHKRONJËS “MIHAL DURI”**

Për funksionimin normal të zyrës së përmbarimit, të zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe të shtypshkronjës për nevojat e sistemit të drejtësisë, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. T'i kalojnë në administrim Ministrisë së Drejtësisë:

a) Mjediset e punës për nëntëmbëdhjetë zyra, që sot janë në përdorim të shtypshkronjës “Mihal Duri”, të cilat gjenden në korridorin e katit të dytë, deri tek rruga e ambasadave me pamje nga hyrja kryesore, si dhe dy magazina në katin e parë të kësaj ndërmarrjeje që i përkasin repartit mekanik dhe repartit të ashpërsimit të lastrave, të ndodhura në pjesën veriperëndimore të godinës së shtypshkronjës “Mihal Duri” me dalje në rrugën e Kavajës.

b) Mjediset e punës, të përbëra nga punishtja e marangozit, punishtja e saldatorit me anekset dhe vendroja e karburantit që gjenden në territorin e shtypshkronjës “Mihal Duri”, prapa krahut në të majtë të godinës së drejtorisë dhe që kufizohen nga perëndimi rruga “Justin Godard”, nga veriu rruga “Halil Xhelo”, nga lindja e jugu oborri i mbrapëm i godinës së drejtorisë me dalje në rrugën “Justin Godard”.

2. Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë të marrin masa për lirimin e këtyre ambienteve brenda datës 30 maj 1996.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi